

ndryshme, ne shqyrtojmë rolin e faktorëve shoqëror, kulturor dhe gjuhësor në formimin e modeleve të qëndrueshme. Për më tepër, hulumtojmë edhe ndikimin e teorive gjuhësore për të kuptuar sa më mirë dukurinë e pranëvënies së këtyre njësive. Duke sintetizuar idetë teorike me të dhënat empirike, ky punim ofron një interpretim të detajuar të mënyrës se si kanë ndryshuar këto togje të gjuhës angleze gjatë shekullit të kaluar, duke ndihmuar sado pak në diskutime më të thelluara për zhvillimin e gjuhës.

Fjalët kyçe: lidhje leksikore, konteksti gjuhësor, marrëdhënie semantike dhe kulturore

A DIACHRONIC APPROACH TO THE STUDY OF ENGLISH COLLOCATIONS

Abstract

This paper presents a diachronic framework for examining English collocations within the context of the 20th century linguistic landscape. Collocations, the recurrent lexical pairings in language, are vital indicators of semantic and cultural relationships. Drawing upon theoretical perspectives from numerous authors, this study investigates the evolution of English collocations throughout the 20th century. By analysing different pieces of work, representing different periods and genres, we interrogate the role of social, cultural, and technological factors in shaping collocational patterns. Additionally, we explore the impact of linguistic theories on our understanding of collocational phenomena. By synthesizing theoretical insights with empirical data, this paper offers a thorough understanding of how English collocations have evolved over the past century, contributing to broader discussions on language evolution and change.

Key words: lexical pairings, linguistic context, semantic and cultural relationships

HYRJE

Studimi i togjeve të qëndrueshme është një fushë e rëndësishme e gjuhësisë që ka të bëjë me analizën e përdorimit të fjalëve dhe shprehjeve të caktuara në kohë dhe zhvillimin e tyre nëpër shekuj. Qasja diakronike në studimin e togjeve të qëndrueshme synon të shpjegojë si dhe pse togje të caktuara janë përdorur në gjuhën angleze ndër vite, duke e shqyrtuar këtë dukuri sa gjuhësore edhe kuptimore në kontekstin e zhvillimit të gjuhës angleze në shekullin e 20-të. Kjo qasje na lejon një kuptim më të thellë të rrugëtimit të këtyre fjalëve dhe

shprehjeve, si edhe ndryshimet e tyre të mundshme në epoka të ndryshme.

Në këtë punim, do të eksplorojmë historinë dhe zhvillimin e disa togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze, duke u përqëndruar në kontekstin e shekullit të 20-të. Për këtë qëllim, do të shqyrtojmë studime të ndryshme, si dhe burime të tjera të literaturës gjuhësore, për të argumentuar përkatësinë dhe rëndësinë e një qasjeje diakronike në këtë fushë të studimit të gjuhësisë. Në fund, do të përpiqemi të sjellim një kuptim më të thellë të përdorimit të togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze dhe ndikimin e tyre në përshkrimin e proceseve gjuhësore në shekullin e kaluar.

SHQYRTIM LITERATURE

Dukuria e pranëvënies së fjalëve u soll në vëmendjen e gjuhëtarëve në vitet 1930 nga kontekstualisti britanik John R. Firth, i cili aktualisht popullarizoi termin “collocation” (pranëvënie, renditje) që vjen nga fjala latine *collocare* (të vendosësh bashkë, të mbledhësh ose të grumbullosh). Por shumë më herët, studime pedagogjike mbi përvetësimin e gjuhës mëmë dhe të huaj ishin marrë me këto togje. Ato konsideroheshin si bashkime fjalësh në gjuhë të cilat kujtoheshin nga folësit si “njësi të tëra” dhe që përbënin mjetet kryesore në arritjen e rrjedhshmërisë në përdorimin e gjuhës. Sipas disa studiuesve, midis të cilëve edhe Gitsaki (1966), këto togje madje janë njohur dhe studiuar edhe nga grekët e lashtë.

Në artikullin “Mënyra të kuptimit” (Modes of Meaning) Firth-i mbështeti rëndësinë e studimit të togjeve të qëndrueshme si një mjet për hulumtimin e pohimeve semantike të kuptimit në gjuhësinë përshkruese (deskriptive). Si rrjedhojë e këtij artikulli, studimi i tyre mund të klasifikohet kronologjikisht në tri periudha kryesore: 1) në vitet 1960, kur këto togje ishin studiuar teorikisht dhe probleme apo çështje të ndryshme lidhur me to ishin diskutuar; 2) vitet 1970, kur ishte sugjeruar metodologjia e studimit të tyre dhe ishin bërë disa përpjekje për t’iu afuar atyre; dhe 3) nga vitet 1980 e në vazhdim, kur rezultatet dhe arritjet e studimit të tyre filluan të shfaqen. Le të shohim më konkretisht se çfarë përfshin secila nga këto periudha në studimin e togjeve të qëndrueshme.

Në vitin 1966, Michael Halliday, John Sinclair dhe Angus McIntosh botuan artikujt e tyre mbi togjet e qëndrueshme. Pas pak do

të shohim se cilat janë karakteristikat dhe rëndësinë e këtyre punimeve në studimin e tyre.

Duke theksuar rëndësinë e studimeve leksikore në gjuhësinë përshkruese – siç theksohet vazhdimisht nga Firth-i – Halliday-i, në “Leksiku si nivel gjuhësor” (Lexis as a linguistic level (1966), thelloi më tej studimin teorik të togjeve të qëndrueshme dhe parashtroi një sërë problemesh, p.sh. nevojën *“për të shëstuar metoda të përshtatshme për përshkrimin e këtyre strukturave në dritën e një teorie leksikore që do të jetë plotësuese, por jo pjesë përbërëse e një teorie gramatikore”* (f. 148). Kështu ai e zhvilloi më tej idenë e tij që e kishte paraqitur më parë në “Kategori të Teorisë së Gramatikës” (Categories of the Theory of Grammar (1966). Sipas Halliday-it, kjo pikëpamje ishte nënkuptuar në njohjen e Firth-it të nivelit të togjeve të qëndrueshme të gjuhës. Megjithatë, meqë në pikëpamjen e Halliday-it kombinimet e një njësie nuk kufizoheshin vetëm në njësi pranëndenjësë, interesi i tij kryesor u bë kohezioni, një çështje më leksiko-gramatikore brenda kufijve më sintetikë të gjuhës, siç edhe është vënë re në termin *“kohezioni bashkëlidhës”* (collocational cohesion) (Halliday & Hasan, 1976: 287). Ky term përshkruhet kështu: *“Ky është thjesht një term për të përshkruar kohezionin që rezulton prej bashkëvendosjes dhe bashkëpërdorimit të njësive leksikore. Këto të fundit, në një mënyrë ose një tjetër, në mënyrë tipike gjenden pranë njëra-tjetrës, sepse kanë prirjen për t’u ndodhur në mjedisë të ngjashme”*.

Punimi i John Sinclair-it “Fillimi i studimit të leksikut” (Beginning the Study of Lexis: 1966) është një artikull paraprak që paraqet një sfond teorik dhe probleme praktike përsa i përket studimit të togjeve të qëndrueshme me anë të kompjuterit. Pothuajse të gjitha termat teknike që përdoren sot në studimin e tyre janë përkufizuar dhe trajtuar në këtë punim: nyje (node), largësi apo hapësirë (span), kuptim formal (formal meaning), togje leksikore (lexical sets), etj. Përveç këtyre termave, Sinclair-i diskuton edhe aspekte të gjuhës – terma leksikore polimorfemike, homograf, polisemi – dhe identifikon problemin e shumëllojshmërisë së gjuhës që mund të krijojë vështirësi praktike në përdorimin e kompjuterave në përdorimin e të dhënave në studimin e togjeve të qëndrueshme.

Interesi kryesor i Halliday-it dhe Sinclair-it fokusohet në bashkimin e zakonshëm të fjalëve më të përdorshme në anglishten e kohës së tyre, kurse Angus McIntosh-i, në punimin e tij “Modele dhe

grupime” (Patterns and ranges: 1966), zgjodhi të merrej me bashkimet e pazakonta. Ai propozoi që nocioni *grupim* “*ka të bëjë me togje të veçanta që krijojnë një seri shembujsh të caktuar*” në lidhje me leksikun. *Grupimi* dallon nga *modeli*, që “*ka të bëjë me strukturat (ndërtimet) e fjalive që formojmë*”, nga ana gramatikore (f. 199). Punimi i McIntosh-it gjithashtu ndryshon nga ato të Halliday-it dhe Sinclair-it në atë që, ndërkohë që këta të fundit u morën me togje të zakonshme dhe mjaft të përdorshme në gjuhën e përditshme, McIntosh-i shqyrtoi rëndësinë e togjeve jo të zakonshme në gjuhën letrare.

Ajo që i bashkon këto punime është se secila prej tyre, në mënyra të ndryshme, thekson se studimi i togjeve të qëndrueshme është studimi i leksikut si një pjesë e pavarur e gjuhës. Të tre, gjithashtu, kanë argumentet e tyre plotësues për studimin e tyre. Kështu, Halliday-i prezantoi këndvështrimin e tij në studimin e leksikut, Sinclair-i e çoi më tej këtë ide duke diskutuar plotësimin e saj me anë të kërkimeve kompjuterike, dhe McIntosh-i e zgjeroi më tej idenë më punën e tij mbi togjet e pazakontë në gjuhë, një fushë me të cilën Halliday-i dhe Sinclair-i nuk u morën pothuajse fare.

Vitet 1970, periudha e dytë e studimit të togjeve të qëndrueshme, mund të konsiderohet si periudha e studimeve pilot apo eksperimentale në fushën e tyre. Dy studiuesit përfaqësues të kësaj periudhe ishin John Sinclair dhe Sydney Greenbaum.

Sinclair-i dhe grupi i tij, duke u mbështetur te bazat teorike të hedhura më parë nga Halliday-i (1966) dhe McIntosh-i (1966), filluan projektin e tyre gjuhësor për studimin e “kuptimit me anë të bashkëlidhjeve të qëndrueshme” të mbështetur më parë nga Firth-i. Ata botuan “Studime leksikore të anglishtes” (English Lexical Studies) në vitin 1970. Sfondi teorik në këtë libër (Sinclair, et al., 1970) pasoi atë të Sinclair-it (1966), por përkufizimet e termave teknike ishin më të sakta dhe më të plota se më parë. Fjala vjen, përkufizimi i togjeve të qëndrueshme në “Studime leksikore të anglishtes” ishte: “*përdorimi pranë njëra-tjetrës i dy njësisive në një tekst brenda [një] mjedisi të caktuar*” (f. 15), por, në fakt, ky term ishte kufizuar vetëm te “*togfjalësha të rëndësishëm*”, që përkufizohej si: “*përdorim i rregullt pranë njëra-tjetrës i dy njësisive, në mënyrë të tillë që ato përdoren së bashku më dendur se ç’mund të parashikonte shpeshësia e përdorimit të secilës prej tyre dhe gjatësia e tekstit ku ato mund të shfaqen*” (f. 15). Shkalla e rëndësisë së shpeshësisë së këtyre togfjalëshave është

testuar statistikisht, dhe togjet që nuk janë njohur si të rëndësishme trajtohen si “togje të rastësishme” dhe si rrjedhim nuk janë analizuar. Në “Studime leksikore të anglishtes”, Sinclair-i dhe studiuesit e tjerë i dinin që në fillim problemet e gjatësisë së tekstit si edhe kufizimet në paraqitjen në kompjuter. Përsa i përket gjatësisë së tekstit, ata pohuan se “*në mënyrë që të përshkruajmë plotësisht sjelljen e këtyre lidhjeve të madje edhe 3000 fjalëve më të përdorshme në gjuhë duhet të kemi të paktën një tekst prej miliona fjalësh*” (f. 23).

Numri i vogël i teksteve të Sinclair-it (et al.) – 135.000 fjalë të anglishtes britanike, 50.000 fjalë të anglishtes së shkruar britanike, dhe pothuajse një milion fjalë të anglishtes së shkruar amerikane nga “Teksti i Universitetit të Braunit” (Brown University Text) që më vonë u njoh si Korpusi Braun – e kufizoi shumë vlefshmërinë e studimit të tyre. Megjithatë, duhet të theksojmë se vlerat e librit “Studime leksikore të anglishtes” qëndrojnë në faktin se ai ndihmoi të hidheshin bazat e metodave dhe parimeve të punës kërkimore si edhe krijoi një bazë të fortë për kërkimet studimore mbi togjet e qëndrueshme në të ardhmen.

Libri i Greenbaum-it “Togfjalësha me përforcues (specifikues) foljor në anglisht: një qasje eksperimentale” (Verb-Intensifier Collocations in English: an Experimental Approach (1970) fillon me kritika ndaj studimit të Sinclair-it (që e përmendëm më lart): “*Fatkeqësisht, studimi, siç është parashtruar në artikullin e tij [Sinclair-it], do të bazohej ekskluzivisht në pranëvendosjen lineare të njësisive, dhe nuk do të përfshinte pohime sintaksore dhe semantike që shpesh janë thelbësore në trajtimin e togjeve të qëndrueshme*” (f.10). Në vend të metodës së hulumtimit të një korpusi (qoftë të folur apo të shkruar), Greenbaum-i propozoi metodën e testimit të “informatorit vendas” (native informant) që përfshin aspektet sintaksore dhe semantike të togjeve të një njësie. Nga eksperimentet e tij me informatore, Greenbaum-i solli shembullin e përdorimit të “much” (shumë) - si përforcues (specifikues) të foljes:¹

6

“Much” (shumë) bashkohet me një folje paraprijëse si “like” (pëlqej) në fjali mohore, por jo në fjali pohore. Kështu mund të themi (f. 11-12):

¹ Yllthi shënon një fjali jo të saktë nga ana gramatikore.

I don't like him much. (Unë nuk e pëlqej atë shumë²por nuk mund të themi:

**I like him much. (Unë e pëlqej atë shumë³)*

Megjithatë, kjo fjali e fundit bëhet e pranueshme nëse “much” (shumë) paraprihet nga një modifikues, p.sh:

I like him very / too / so much. (Unë e pëlqej atë kaq shumë)

Rezultati i Greenbaum-it është interesant dhe i vlefshëm, por përjasja e tij nuk është pa probleme, p.sh. sipas testeve të tij të bëra me informatorë të ndryshëm, “agree” (bie dakord) shfaqet në 82% të përgjigjeve pas “I entirely” (unë plotësisht) (f. 80). Megjithatë, duket se Greenbaum-i nuk mori mjaftueshëm parasysh përgjigjet nga 18% informatorët e mbetur dhe njëkohësisht nuk e bëri shumë të qartë përkufizimin e tij të “informatorit vendas”. Për më tepër, kjo përjasje kufizohet vetëm në studimin e anglishtes së kohës – për arsyen e thjeshtë se është e pamundur të gjesh informatorë vendas nga shekujt e kaluar – dhe nuk mund të zbatohet për studimin diakronik të togjeve të qëndrueshme.

Që nga vitet 1980 e në vazhdim, zhvillimi i shpejtë i kompjuterave dhe gjuhësisë së korpusit e çoi shumë përpara projektin e Sinclair-it që tashmë njihet si projekti COBUILD. Korpusi i tij shumë i madh, i njohur si “Bank of English” (Fondi i Anglishtes), nuk ka ndihmuar vetëm në studimin e togjeve të qëndrueshme, por edhe në hartimin e fjalorëve.

Në fillim të shekullit të 20-të, Harold Palmer, i cili ishte ndër të parët që e studioi anglishten si gjuhë të huaj (EFL), gjithashtu vuri re prezencën e të ashtuquajturave poliglose (polyglos) ose “njësi të njohura” (known units) në gjuhë. Ai hartoi një listë prej mbi 6.000 togjesh të thjeshta të cilat i përfshiu në mësimdhënien e tij në mënyrë që studentët t'i mësonin si një njësi e vetme. I njëjti interes për njësitë frazeologjike e çoi paraardhësin e tij Albert Sydney Hornby të përfshinte informacionin rreth këtyre togjeve në fjalorë nga seria e të cilave ai filloi me “Idiomatic and Syntactic English Dictionary” (Fjalori Idiomatik dhe Sintaksor i Anglishtes) (1942).

²Ky është një përkthim fjalë për fjalë për të kuptuar më mirë strukturën e anglishtes. *Unë nuk e kam shumë qejf atë.*, do të ishte një përkthim më i përshtatshëm.

³ Siç shihet, në shqip ky kombinim është i mundur edhe në fjali pohore, jo vetëm në fjali mohore si në anglisht.

Kjo prirje pedagogjike u vazhdua, në mënyrë të veçantë, nga Anthony P. Cowie, Peter Howarth dhe Michael Lewis. Ky i fundit i quan këto togje si “ishuj të besueshmërisë” (islands of reliability) së thënies të folësve. Vitet e fundit kanë treguar një rritje të interesit në studimin e togjeve të qëndrueshme në kontekstin e mësimdhënies së gjuhëve të huaja si edhe në përpjekjet e shumta për hartimin e fjalorëve për shumë gjuhë. Kështu, mund të thuhet se këto togje dalin në pah fillimisht nga vëzhgime pedagogjike në përvetësimin e gjuhës. Një nivel i lartë i përvetësimit të tyre mund të arrihet nga folësit vetëm nëpërmjet mbajtjes mend të tyre, që duket si një privilegj vetëm për folësit vendas. Interesi pedagogjik për këto togje solli edhe një motivim të fortë për studimin e tyre, grumbullimin dhe analizën e tyre në perspektivën e mësimdhënies së gjuhës.

NJË VËZHGIM MBI PËRKUFIZIMET

Për të kuptuar më mirë termin “bashkëlidhje” – ashtu siç është prezantuar brenda kornizave të kontekstualizimit ose përshkruar në studime më të hershme gjuhësore – duhet të kuptojmë lidhjen e afërisë që ekziston midis fjalëve të një gjuhe dhe që del në pah nga shfaqja tipike e fjalëve, d.m.th, prania apo shfaqja e fjalëve në kontekst të njëra-tjetrës. Kontekstualistët pohojnë se, në karakterizimin e një fjale, konteksti i saj luan rolin më të rëndësishëm: “*Një fjalë do ta njihni nga fjalët e tjera që e shoqërojnë!*” (Firth; 1957, f. 179) Më herët Charles Bally (1909) përdori shprehjet “togfjalësha të zakonshëm” (usual phrases) për t’iu referuar fjalëve që tregonin një farë afërie për njëra-tjetrën ndërkohë që ruanin autonominë e tyre (1951, f. 70-72). Për të përshkruar këtë lloj lidhjeje afërie, Eugenio Coseriu (1967) më vonë përdori metaforën “solidaritet leksikor” (lexical solidarity).

Kjo lidhje afërie leksikore nuk mund të njehsohet nga proceset rregullatore të gjuhës meqë nuk mund të shpjegohet mbi bazat e rregullave të gramatikës të zbatuara te kategoritë e fjalëve. Ashtu si thekson edhe Igor Mel’čuk [*frazema – në veçanti togjet e qëndrueshme*] nuk mund të ndërtohen (...) nga fjalë ose togfjalësha më të thjeshtë sipas rregullave të përgjithshme të [gjuhës], por duhet të ruhet dhe të përdoret si një e tërë” (1998).

Ndërkohë që karakterizimi me anë të lidhjes së afërisë ndihmon në të kuptuarit e konceptit të këtyre togfjalëshave, këto përkufizime mbeten mjaft të paqarta, sepse asgjë nuk është thënë për statusin dhe

tiparet e tyre gjuhësore. Duke mos pasur një përkufizim të saktë, termi “bashkëlidhje” gjatë gjithë kohës është ngatërruar dhe është përdorur në vende të ndryshme për të treguar dukuri të ndryshme gjuhësore. Kështu Jens Bahns-i thekson se “*ky term përdoret dhe kuptohet në shumë mënyra të ndryshme*” (1993, f. 57). Pavarësisht nga shumëllojshmëria e pikëpamjeve të ndryshme, është e mundur të përcaktohen dy perspektiva kryesore në konceptin e togjeve të qëndrueshme: një që është thjesht statistikore dhe një tjetër që është më e motivuar nga ana gjuhësore. Tani do të vëzhgojmë disa nga përkufizimet më përfaqësuese të secilit grup me radhë.

Qasja Statistikore

Përkufizimet pedagogjike dhe kontekstualiste të përmendura deri tani nënkuptojnë një element statistikor. Në mënyrë që të përvetësohen nga folësit nëpërmjet mbajtjes mend si një njësi e vetme, togjet e qëndrueshme duhet të identifikohen mbi bazat e shpeshtësisë së tyre – që do të thotë, ato duhet të gjenden pranë shumë herë që të mund të perceptohen si kombinime të zakonshme fjalësh. Në mënyrë të ngjashme, në kontekstualizëm këto togje përshkruhen në bazë të bashkëndodhjes tipike të fjalëve, ose si fjalë që tregojnë “*prirjen për t’u gjendur apo përdorur së bashku*” (Sinclair; 1991, f. 71). Nocionet e shpeshtësisë, tipizimit ose prirjes u referohen tipareve që modelohen në statistikë.

Në fakt, shumica e përkufizimeve adaptojnë një pikëpamje statistikore. Megjithëse dukuria e përshkruar ka një konotacion gjuhësor të fshehur, aspektet gjuhësore shpesh injorohen; kështu, si rezultat, në qasjet e pastra statistikore përkufizimet pothuajse gjithmonë jepen ekskluzivisht në terma statistikorë. P.sh. Firth-i (1957) jep këtë përkufizim: *Togjet në të cilat gjendet një fjalë e dhënë janë pohime të vendeve të zakonshme të asaj fjale* (f. 181).

Në shembujt që ai sjell mund të gjejmë çifte si *night (natë) – dark (e errët)*, *bright (e ndritshme) – day (ditë)*, ose *milk (qumësht) – cow (lopë)* (f. 196). Siç mund të shihet, të kuptuarit e konceptit në kontekst është shumë i gjerë, pasi përveç lidhjeve sintagmatike që vërtet mund të ndërtojnë njësi frazeologjike (tofjalëshore) – *dark night (natë e errët)* dhe *bright day (ditë e ndritshme)*, kemi edhe lidhje josintagmatike si *milk – cow* që janë të motivuara semantikisht.

Kjo pikëpamje statistikore është dominuese në punën e Firth-it, M. A. K. Halliday-it, Michael Hoey-it dhe John Sinclair-it. Vendosja e fjalëve në togje përsëri interpretohet në një kuptim të gjerë, ashtu si vendosja e shpesh të një fjale në kontekst të një tjetre (ku konteksti paraqet ose të gjithë fjalinë, ose një dritare fjalësh të quajtur “hapësirë” (span): *Vendosja e fjalëve në togje është vendosja pranë njëra-tjetrës e dy ose më shumë fjalëve brenda një hapësire të shkurtër në një tekst. Matja e zakonshme e afërsisë është një maksimum i katër fjalëve në mes tyre* (Sinclair; 1991, f. 170).

Edhe përkufizime të mëvonëshme, si ato më poshtë, janë dhënë ekskluzivisht në terma statistikore: *Termi “bashkëlidhje” do të përdoret për t’iu referuar ndërtimeve të njëjësive leksikore që zakonisht gjenden pranë njëra-tjetrës* (D. A. Cruse; 1986, f. 40).

... *“bashkëlidhje” është një kombinim arbitrar dhe i shpesh të fjalësh* (Morton Benson, 1986). *Gjuhët natyrale janë plot me togje, kombinime të shpeshta të fjalëve që përdoren bashkë më shpesh sesa pritet rastësisht dhe që korrespondojnë me përdorime arbitrare të fjalëve* (Frank Smadja; 1993, f. 143). *Ne e rezervojmë termin “bashkëlidhje” për t’iu referuar çdo përdorimi të rëndësishëm statistikisht* (Ivan Sag, et al. 2002, f. 7).

Një veçanti e këtyre qasjeve statistikore është se ato i shohin togjet e qëndrueshme si lidhje simetrike, duke mos i kushtuar vëmendje rëndësisë relative të fjalëve të përfshira. Kështu, Firth-i (1957, f. 196) i përshkuan këta togfjalësha në lidhje me pritshmërinë e dyfishtë (apo reciproke): *Një nga kuptimet e **night (natë)** është vënia pranë **dark (e errët)** dhe anasjelltas (...) Krijimi i një togu nuk mund të merret thjesht si vënia pranë e një fjale ose e një “pjesë”, por si një renditje e pritshmërisë së dyfishtë* (Firth; po aty, f. 181).

Cruse (1986, f. 40) gjithashtu pohon se në një bashkëlidhje *“elementët përbërës janë në shkallë të ndryshme, të zgjedhura reciprokisht.”* Po kështu, Sinclair-i (1991, f. 173) vë re se *“bashkëlidhja është një nga ndërtimet e zgjedhjes reciproke.”*

Qasja Gjuhësore

Ndryshe nga qasjet kontekstualiste (dhe të ngjashme me to), në qasje të tjera, lidhja sintaksore midis njëjësive të togjeve të qëndrueshme është një tipar qëndror përcaktues. Në qasjet gjuhësore, këto togje trajtohen, pikë së pari, si shprehje të një gjuhe. Kjo pikëpamje thekson statusin

gjuhësor të këtyre togjeve duke i konsideruar si kombinime të motivuara sintaksorisht; si rrjedhim, fjalët përbërëse duhet të jenë të lidhura sintaksorisht. Ky kusht strukturor e mposht kushtin e përafërisë që kërkon që fjalët të gjenden brenda një hapësire të shkurtër midis tyre. Përkufizimet e mëposhtme theksojnë kushtin se togjet e qëndrueshme janë ndërtime të formuara mirë nga ana sintaksore: *Vëniapranë e dy ose më shumë njësive leksikore si realizime të elementeve strukturorë brenda një modeli të dhënë sintaksor* (Cowie; 1978, f. 132). *Një sekuencë fjalësh që gjendet më shumë se një herë në formë identikë në një korpus, dhe që është ndërtuar mirë nga ana gramatikore* (GöranKjellmer; 1990, f. 133). *Ne do të quajmë togfjalësh të qëndrueshëm një kombinim karakteristik të dy fjalëve në një strukturë si: emër + mbiemër (epitet), emër + folje, folje + emër (kundrinor), folje + ndajfolje, mbiemër + ndajfolje, emër + (parafjalë) + emër* (F. J. Hausmann; 1989, f.1010). *Një togfjalësh i qëndrueshëm është një sekuencë e dy ose më shumë fjalëve, që ka karakteristikat e një njësie sintaksore dhe semantike, kuptimi i saktë dhe i dretpërdrejtë i të cilit ose konotacioni nuk mund të dalë drejtpërdrejt nga ngjyrimi i përbërësve të tij* (Y. Choueka; 1988). *Një togfjalësh i qëndrueshëm është një shprehje që përbëhet nga dy ose më shumë fjalë që i referohen një mënyre konvencionale për thënien e gjërave* (Christopher Manning, et al. 1999, f. 151). Pranëvënie të shpeshta të kufizuara leksikalisht dhe /ose pragmatikisht të paktën e dy njësive leksikore që janë në një lidhje të dretpërdrejtë sintaksore me njëra-tjetrën (Bartsch; 2004, f. 76). Një nga përkufizimet gjuhësore më të plota të këtyre togjeve ka dhënë Igor Mel'čuk në kornizat e Teorisë Kuptim-Tekst (Meaning-Text Theory) me anë të formalizimit të funksioneve leksikore (1998, 2003). Ky përkufizim, gjithashtu, e konsideron lidhjen në këto togfjalësha si një kombinim fjalësh të lidhura sintaksorisht.

Në kontrast me qasjet statistikore, bashkimi këtu shihet si një lidhje e dretpërdrejtë (asimetrike) ku roli që luhet nga fjalët përbërëse është i pabarabartë, dhe kryesisht vendoset nga konfigurimi sintaksor. Shumë studiues janë përpjekur të sjellin një karakterizim më të saktë të togjeve të qëndrueshme nga pikëpamja gjuhësore, domethënë, të kapin tiparet e tyre të brendshme sintaksore dhe semantike për t'i dalluar nga njësi të tjera frazeologjike dhe për të lejuar kuptueshmërinë e tyre në zbatime të ndryshme.

RRETH KONCEPTIT TË TOGJEVE TË QËNDRUESHME

Siç e kemi theksuar, shumë përkufizime të tyre gjenden në literaturë. Shumë prej tyre janë të ndryshme dhe mund të shkaktojnë çoroditje pavarësisht faktit se një dallim kryesor mund të nxirret sipas pikëpamjes statistikore në kundërvëniet me atë të motivuar nga ana gjuhësore. Në pjesën në vijim do të përpiqemi të paraqitim një pamje të unifikuar duke kapur tiparet më thelbësore që duket se përbëjnë konceptin bazë të tyre. Pavarësisht nga pikëpamjet e ndryshme, duket se disa prej tipareve mund të gjenden vazhdimisht të shprehura dhe të pranuar nga shumica e autorëve.

Ne mendojmë se këto tipare tregojnë për konceptin bazë të këtyre lidhjeve dhe ky konceptim mund të thellohet duke shtuar element të tjerë më të veçantë. *“Duke u mbështetur te interesat dhe pikëpamjet e tyre, kërkuesit janë fokusuar në aspekte të ndryshme të këtyre njësive”* (Smadja; 1993, f. 145). *“Unë përdor termin “bashkëlidhje” si një term të përgjithshëm, kuptimi i veçantë i të cilit mund të ngushtohet sipas kërkesave të një hulumtimi të veçantë ose zbatimi të tij”* (Evert; 2004, f. 17). Më poshtë po japim tiparet që ne i gjykojmë si të rëndësishme në përkufizimin e konceptit bazë të togjeve të qëndrueshme.

Këto njësi janë togje të parafabrikuar

Studimet mbi përvetësimin e gjuhës kanë treguar se fëmijët mbajnë mend jo vetëm fjalë të izoluar, por edhe grupe fjalësh. Këto togje konsiderohen si blloqe ndërtimi të gjuhës. Ato janë në dispozicion të folësve si njësi të gatshme ose të parafabikuara që kontribuojnë në rrjedhshmërinë dhe natyrshmërinë e thëniesve të tyre. Siç e kemi përmendur edhe më parë, njohuritë e folësve për këto togje nuk rrjedhin nga fakti se ata njohin fjalë të veçuara apo rregullat gramatikoretë gjuhës; përkundazi, togjet përvetësohen si të tillë nga eksperiencia apo përdorimi: *“Ne i mësojmë ato ashtu si mësojmë aspekte të tjera të gjuhës, përmes teksteve që lexojmë gjatë jetës sonë”* (Hoy; 1991, f. 219). Sipas Sinclair-it (1991), gjuha udhëhiqet nga dy parime të kundërta: “parimi i hapur” (open principle), që i referohet zgjedhjeve të rregullta në përdorimin e gjuhës dhe “parimi idiomatik” (idiom principle), që i referohet përdorimit të njësive të parafabikuara tashmë të gjendshme në bllok. Këto njësi i korrespondojnë parimit të dytë; ato janë: *togje gjysmë të ndërtuara paraparakisht që përbëjnë zgjedhje të vetme, megjithëse duken si të analizueshme në segmente”* (Sinclair;

1991, f.110). Kjo ide ishte shprehur edhe më parë nga Hausmann-i (1989, f. 124), i cili i quan “prodhime gjysmë të përfunduara” të gjuhës dhe i shoqëron me një efekt “déjà-vu” në gjuhë. E njëjta ide e unitetit sugjerohet edhe nga metafora “solidaritet leksikor” e Coseriu-t (1967). Disa shembuj të këtyre togjeve mund të përmendim: *heavy rain, fast food, take a break, traffic jam, bitterly cold, speak fluently*, e shumë të tjerë.

Këto njësi janë arbitrare

Një tjetër tipar që përmendet në shumicën e përkufizimeve është arbitrariteti në kundërvënie me rregullshmërinë (d.m.th. sipas rregullave të gjuhës). Këto togje nuk janë prodhime të rregullta të gjuhës, por “përdorim arbitrar fjalësh” (arbitrary word usages) (Smadja, 1993), “kombinime arbitrare fjalësh” (arbitrary (...) word combinations) (Benson, 1990), ose “kombinim tipik, specifik dhe karakteristik i dy fjalëve” (typical, specific and characteristic combination of two words) (Hausmann, 1989). Një numër i madh përkufizimesh të tjera e theksojnë këtë aspekt, p.sh. Fontenelle (1992), Van der Wouden (1997), dhe Mel’čuk (2003).

Fakti që këto togje janë njësi të parafabrikuara në leksikun e një gjuhe tregon që ato duhet të mësohen dhe përdoren si të tilla dhe njëkohësisht pengon rindërtimin e tyre me anë të proceseve gramatikore. Faktikisht, nuk mund të ketë një arsye të qartë për zgjedhjen e veçantë të fjalëve në një ndërtim të tillë, por sapo bëhet zgjedhja dhe “institucionalizohet” (duke përdorur termin e Sag-ut), perifrazimet a tjera nuk janë të mundura, ashtu si parashikohet edhe në parimin idiomatik të Sinclair-it.

Arbitrariteti i një togfjalëshi të tillë mund t’i referohet jo vetëm zgjedhjes së një fjale në lidhje me një tjetër për të shprehur një kuptim, por edhe tipare të tij sintaksore dhe semantike. Një tog i tillë është një kombinim fjalësh tiparet semantike dhe/ose sintaksore të të cilit nuk mund të parashikohen plotësisht nga ato të përbërësve të tij, dhe që, si rrjedhim, duhet të konsiderohen si pjesë e leksikut të një gjuhe. (Evert; 2004, f. 17).

Këto njësi janë të paparashikueshme

Paparashikueshmëria është një tjetër tipar i rëndësishëm i lidhur ngushtësisht me dy të përmendurat më lart. Ky tipar citohet shpesh në përkufizime të ndryshme. Meqë “institucionalizimi” i togut të qëndrueshëm si një njësi e parafabrikuar nuk varet nga arsye të qarta

gjuhësore, atëherë është e pamundur ta parashikosh një të tillë. Së pari, përdorimi i një fjale pranë një tjetre që preferohet mes shumë fjalëve të tjera sinonimike është e paparashikueshme. Siç shprehet edhe Cruse (1986) *“këto përdorime nuk mund të parashikohen në bazë të rregullave semantike dhe sintaksore, por mund të vëzhgohen rregullisht në tekst.”* Së dyti, tiparet morfo-sintaksore të tyre nuk mund të parashikohen në bazë të tipareve të fjalëve përbërëse. Disa shembuj të këtyre togjeve mund të përmendim: *utter nonsense, foot the bill, brain drain, painfully shy, catch a cold, cry bitterly* etj.

Pjesët përbërëse të këtyre njësive përdoren rregullisht pranë njëri-tjetrit

Tipari që duket si më i përmenduri në përkufizime të ndryshme është, pa dyshim, përdorimi i rregullt dhe i shpeshtë pranë njëri-tjetrit i elementëve përbërës të tyre. Është pikërisht ky përdorim i shpeshtë që përcakton “institucionalizimin” e tyre. Në të njëjtën kohë, ky tipar bën të mundur njohjen e tyre dhe të mësuarit me anë të eksperiencës: *“ne i mësojmë këta togfjalësha (...) përmes teksteve që lexojmë gjatë jetës sonë”* (Hoy; 1991, f. 219). Një togfjalësh i qëndrueshëm “*vjen natyrshëm, i gatshëm në mendje; ai është i spikatur psikologjikisht*” (Benson et al.; 1986, f. 252). Siç e kemi përmendur edhe më parë, shumica e përkufizimeve të cituara, përmendin natyrën përsëritëse të tyre. Ato janë: *“fjalë aktuale në kompani të zakonshme”* (Firth; 1968, f. 182), *“kombinime fjalësh të përsëritura”* (Benson, 1986), *“kombinime fjalësh që përdoren bashkë më shpesh se ç’mund të pritët rastësisht”* (Smadja; 1993, f. 143), *“togfjalësha të zakonshëm”* (Bally, 1909), *“togfjalësha të institucionalizuar”* (Sag et al., 2002, f. 3).

Këto njësi përbëhen nga dy ose më shumë fjalë

Pavarësisht se shumë punime praktike merren me togje që përbëhen nga dy njësi leksikore, në teori, nuk ka ndonjë kufi në gjatësi për to. Ashtu si shprehet edhe Sinclair-i: *“Në shumicën e shembujve, modelet e këtyre togjeve kufizohen në çifte fjalësh, por nuk ka ndonjë kufizim teorik për numrin e fjalëve të përfshira.”* (1991, f. 170). Në fakt, shumica e përkufizimeve përmendin që këto togje mund të përfshijnë më shumë se dy njësi: *“bashkë-përdorimi i dy ose më shumë fjalëve ndjekëse”* (Cowie, 1978), *“renditja e dy ose më shumë fjalëve ndjekëse”* (Choueka, 1988), *“bashkë-përdorimi i dy ose më shumë fjalëve brenda një hapësire të shkurtër”* (Sinclair; 1991, f. 170), *“një*

shprehje që përbëhet nga dy ose më shumë fjalë” (Manning et al., 1999, f. 151). Togje të tilla janë të shumta në gjuhën angleze:
major turning point (pika kryesore e kthimit)
play a central role (të luash një rol të rëndësishëm)
conduct a comprehensive study (të kryesh një studim gjithëpërfshirës)
abolish the death penalty (heq dënimin me vdekje)
become an increasingly important concern (është bërë çështje e ditës)
Vetëm në raste të rralla, studimet teorike përmendin qartë prezencën e vetëm dy njësive leksikore në një togfjalësh. Megjithatë, këto njësi mund të përbëhen nga fjalë të tjera dhe veçanërisht nga togfjalësha të tjerë, si shembujt që përmendëm pak më lart.

PËRFUNDIME

Studimi i togjeve të qëndrueshme në gjuhën angleze gjatë shekullit të 20-të ka qenë një fushë e rëndësishme e gjuhësisë që ka shërbyer për të kuptuar zhvillimin e kësaj gjuhe dhe shoqërisë së saj. Duke shqyrtuar literaturën e shekullit të kaluar, kemi vënë re se si këto togje të qëndrueshme përgjatë kohës kanë reflektuar ndryshimet në perceptimet dhe përvojat njerëzore.

Në një pikëpamje më të gjerë, kuptimi i togjeve të qëndrueshme është shumë më tepër se thjesht një interes akademik. Ato ofrojnë një dritare unike në historinë dhe kulturën e një gjuhe, duke na lejuar të shohim se si mendimi dhe perceptimet njerëzore kanë ndryshuar në kohë. Me vazhdimin e hulumtimit në këtë fushë, do të përpiqemi të sjellim një qasje krahasimore, duke iu referuar edhe gjuhës shqipe për të evidentuar më konkretisht ngjashmëritë dhe ndryshimet e mundshme midis këtyre togjeve në të dyja gjuhët. Kështu, pritet që të kuptohet më mirë përcaktimi dhe funksioni i tyre në zhvillimin e gjuhës angleze dhe shqipe. Në këtë mënyrë, studimi i togjeve të qëndrueshme vazhdon të jetë një sfidë e frytshme për gjuhëtarët dhe shkencëtarët e kulturës në të ardhmen.

REFERENCAT

- Bahns, J. (1993). “Lexical collocations: a contrastive view”. *ELT Journal*, 47 (1), 56-63.
- Bally, Ch. (1909). *Il Traite de stylistique française*. Ed. Winter, ad Heidelberg.
- Bartsch, S. (2004). *Structural and functional properties of collocations in English*. A corpus study of lexical and pragmatic constraints on lexical

- co-occurrence. Tübingen, Narr.
- Benson, M. (1986). *Lexicographic Description of English*. Philadelphia: J. Benjamins Pub. Co.
- Choueka, Y. (1988). "Looking for needles in a haystack". Proceedings of RIAO '88, pp. 609–623
- Coseriu, E. (1954/1967). *Forma y sustancia en los sonidos del lenguaje* [1954], in Eugenio Coseriu, *Teoría del lenguaje y lingüística general*. Cinco estudios, Segunda edición, Madrid, Editorial Gredos, 1967, p. 115–234.
- Cowie, A.P. (1978) "The place of illustrative material and collocations in the design of a learner's dictionary" in In Honour of A.S. Hornby ed. by P. Strevens. Oxford: U.P.
- Cruse, D. A. (1986). *Lexical Semantics*. Cambridge University Press.
- Evert, S. (2004). *The Statistics of Word Cooccurrences (Word Pairs and Collocations)*. Ph. D. dissertation, Universität Stuttgart.
- Firth, J. R. (1957). A Synopsis of Linguistic Theory, 1930-1955. In: *Studies in Linguistic Analysis*.
- Firth, J. R. (1957). "Modes of Meaning", in J. R. Firth, *Papers in Linguistics, 1934–51*. London, New York: Oxford University Press.
- Gitsaki, C. (1996). *The Development of ESL Collocational Knowledge*. A thesis submitted for a Phd in the Centre for Language Teaching and Research at The University of Queensland www.cltr.uq.oz.au:8000/users/christina.gitsaki/thesis/contents.html
- Greenbaum, S. (1970). *Verb-intensifier collocations in English: An experimental approach* (Vol. 86). Walter de Gruyter.
- Halliday, M.A.K. (1961). "Categories of the theory of grammar". *Word*, 17, 241-92. Reprinted in part in Kress (1976), 52-72.
- Halliday, M. A. K. (1966). Lexis as a linguistic level. C.E. Bazell, J.C. Catford, M.A.K. Halliday & R.H. Robins (Eds.), In memory of J.R. Firth (148-162). London: Longman.
- Halliday, M.A.K. and Hasan, R. (1976). *Cohesion in English*. London: Longman
- Hausmann F. J. (1989). "Le dictionnaire de collocations". In Hausmann F.J., Reichmann O., Wiegand H.E., Zgusta L. (eds), *Wörterbücher : ein internationales Handbuch zur Lexicographie*. Dictionaries. Dictionnaires. Berlin/New-York, De Gruyter, 1010-1019.
- Hoey, M. (1991). *Patterns of Lexis in Text*. Oxford University Press.
- Kjellmer, G. (1990). "Patterns of collocability". In: J. Aarts I W. Meijs (Eds.) *Theory and Practice in Corpus Linguistics*, Amsterdam: Rodopi.
- Lewis, M. (2000). "Language in the lexical approach". In M. Lewis (Ed.). *Teaching collocation:*

- Further developments in the lexical approach (pp. 133-134). London: Language Teaching Publications.
- Manning, C. D. (et al.). (1999). *Foundations of Statistical Natural Language Processing*. The MIT Press. Cambridge, Massachusetts. London, England.
- McIntosh, A. (1966). "Patterns and ranges". In A. McIntosh, & M.A.K. Halliday, (eds.) *Patterns of Language: Papers in General Descriptive and Applied Linguistics* (pp. 183-199). London: Longman.
- Mel'cuk, I. (1998). "Collocations and lexical functions". in A.P. Cowie (ed.), *Phraseology. Theory, Analysis, and Applications*, Oxford: Clarendon Press, 23-53.
- Sag, I. (et al.). (2002). Multiword expressions: linguistic precision and reusability. Available at <http://www.lrec-conf.org/proceedings/lrec2002/pdf/145.pdf>.
- Sinclair, J. M. (1966). "Beginning the study of lexis" in C. Bazell et al. (eds.) *In Memory of J.R. Firth*. London: Longman, 410-430.
- Sinclair, J. M., S. Jones, and R. Daley. (1970). [2004, ed. R. Krishnamurthy]. *English Lexical Studies*, report to the Office of Scientific and Technical Information (OSTI).
- Sinclair, J. (Ed.) (1991). *Corpus, Concordance, Collocation*. Oxford, UK: Oxford University Press.
- Smadja, F. (1993). Retrieving Collocations from Text: Xtract. *Computational Linguistics*, 19(1):143-178.

IV- *HISTORI/ TRASHËGIMI KULTURORE*

WORLD HERITAGE SITE OF BUTRINT, ALBANIA: TOURISTS' PERCEPTIONS AND MANAGEMENT

Edlira MENKSHI
Ermira JASHIKU
**Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë
Universiteti "Fan S. Noli"**

Abstract

World Heritage Sites represent the most important tourist attraction in many countries. Butrint is an Albanian archeological site inscribed to the List of World Heritage in 1992, for its Outstanding Universal Value by the Criterion (iii). The archaeological site is already known worldwide and is Albania's most visited tourist attraction. This paper aims to identify the heritage values of the Butrint and the challenges of management related to tourism development and the protection of its outstanding values. The tourists who visit the world heritage site seek a value-added and authentic experience that is related to their perceptions of the information they provide about outstanding values, cultural heritage preservation, and promotion, site management, tourist facilities, as well as the protection of the natural environment. By analyzing the tourist group's perceptions results, the research can provide an initial reference to consider by the managers for the improvement of the tourist services system and the preservation of cultural and natural ecosystems of the world heritage property.

Keywords: *national park, outstanding values, archeological excavation, site management, tourist perceptions, management plan.*